REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.11.2022)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:36 dhe mbaroi në orën 14:51.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
7. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
9. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami*** si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor***, znj. Fatmira Luli***.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Maela Alicanaj, Këshilltare Ligjore pranë Njësisë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet mënyrë të përhershme", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).[1]

Çështja e cila është për trajtim në rendin e ditës së sotme datë 24.11.2022, ora 14:30 lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kërkesat do të relatohen nga zonja Alicanaj e cila merr fjalën duke parashtruar se nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës janë hartuar relacionet pas kërkesave të 3 gjykatave për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta.

Fillimisht propozohet radha e procedurave të shortit:

A. Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, sipas kësaj radhe:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

II. Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit Administrativ, sipas kësaj radhe:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë.

Pasi anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime me radhën e procedurave të shortit, vijohet me relatimin e relacioneve përkatëse.

[1] Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet,** e cila ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t'i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Çështja gjykohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Më parë është përzgjedhur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për të plotësuar trupin gjykues, por për shkak të shkarkimit të një gjyqtareje lind nevoja për t'u plotësuar përsëri trupi gjykues.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, në ndryshim nga rregulli i zakonshëm të mos përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër: znj. Suela Dashi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Suela Dashi.

Vijohet me kërkesën e **Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë**, e cila nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së shortit dhe ka paraqitur nevojë në 1 çështje, në lënde penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Bazuar në nenin 385/a të Kodit të Procedurës Penale, çështjet penale që kanë objekt plotësimin e vendimeve shqyrtohen me të njëjtin trup gjykues. Trupi gjykues që ka shqyrtuar themelin e kësaj

çështjeje është plotësuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor në shkurt të vitit 2021 dhe duke caktuar si anëtar të trupit gjykues z. Petraq Çuri. Në këto kushte, Komisioni propozon që për kërkesën "Ndreqje e vendimit penal" gjyqtar të caktohet gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, z. Petraq Çuri. Pra kjo çështje nuk është e normuar nga shorti por nga normat e Kodit të Procedurës Penale.

E pyetur nga zonja Ukperaj nëse duhet të merret vendim apo jo nga ana e Këshillit, zonja Alicanaj sqaron se kjo pjesë do jetë pjesë e vendimit të delegimeve, i cili nuk normohet nga shorti. Vendimi i cili del në fund të përfundimit të delegimeve, patjetër që ka një kre lidhur me kërkesën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, që caktohet gjyqtari Petraq Çuri, për të plotësuar trupin gjykues në çështjen me objekt "Ndreqje e vendimit penal" (nuk normohet nga shorti por nga normat e Kodit të Procedurës Penale.

Zoti Hallunaj çmon se duhet të ketë një vendimmarrje.

Zoti Rusi fton relatorin të kalojë në propozimin përkatës që më pas Këshilli të kalojë në vendimmarrje sepse në rendin e ditës është përcaktuar "gjyqtarët me short", kështu që në këtë eventualitet të artikulohet propozimi përkatës.

Zonja Ukperaj merr fjalën si vijon:

Bëhet fjalë për kërkesë nga Gjykata e Kavajës që kërkon caktim gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues për ndreqje gabimi material në vendimin penal.

Gjykata nuk di ta zbatojë Kodin e procedurës Penale, që e shqyrton i njëjti trup gjykues? Se të investohet Këshilli për këtë gjë?

Zonja Alicanaj sqaron se gjykata ka përcjellë si problem që gjyqtari është caktuar me vendimin e mëparshëm të KLGJ-së që daton para një viti, i cili është caktuar vetëm për gjykimin e një çështjeje specifike, me numër regjistri të veçantë dhe datë regjistrimi të veçantë.

Nga ana e anëtarëve të Këshillit (zoti Hallunaj dhe zonja Ukperaj) janë të mendimit që

nga ana e Këshillit duhet të ketë një vendim formalisht. Zoti Hallunaj shprehet se gjyqtari nuk mund të shkojë nga një gjykatë në një gjykatë tjetër, pavarësisht se ka qenë pjesë e trupit gjykues.

Sqaron zoti Kurushi se është paraqitur një kërkesë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë që kërkon posaçërisht atë gjyqtar që ka dhënë vendimin. Komisioni propozon që ky gjyqtar s'mund të hidhet në short, por patjetër që një vendimmarrje duhet ta marrë Këshilli, që këtë gjyqtar, referuar dispozitës përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, duhet bërë pjesë e trupit gjykues që do të gjykojë çështjen në Gjykatën e Kavajës, me objekt: "Ndreqje gabimi material".

Zoti Rusi fton zoti Kurushi që të artikulojë propozimin e më pas për ta hedhur në votim.

Pas konsultimin me materialin, zoti Kurushi parashtron edhe një herë propozimin si më poshtë vijon:

Caktimin e gjyqtarit Petraq Çuri, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shqyrtimin e kërkesës penale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për gjykimin e çështjes penale me numër regjistri 71002-01312-12-2022, datë 14.11.2022.

Pjesët e tjera janë të parashikuara në relacionin përkatës që lidhet me: Kërkesa është bërë nga Prokuroria Kavajë dhe objekti është "Ndreqje e vendimit (e gabimit) penal" të vendimit nr. 601, datë 12.04.2021.

Hidhet në votim propozimi i bërë nga zoti Kurushi (komisioni):

Dritan Hallunaj është pro.

Irena Plaku është pro.

Marçela Shehu është dakord.

Yllka Rupa është pro.

Brikena Ukperaj është pro.

Alban Toro është dakord.

Klodian Kurushi është dakord.

Ilir Rusi është dakord.

Ridvan Hado e shpreh votën nëpërmjet e-mailit, në pamundësi për të votuar me audio për shkak të ndonjë defekti teknik. Vota e tij dakord, e shprehur nëpërmjet e-mailit, do të administrohet për efekt të procesverbalit dhe do t'i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.

(Miratohet.)

Vijohet me kërkesat e **Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë**, e cila ka paraqitur nevojë në 2 çështje (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Për çështjen e parë kërkohet plotësimi i trupit gjykues me 1 (një) gjyqtar, pasi janë miratuar kërkesat për heqje dorë të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë. Për çështjen e dytë kërkohet plotësimi i trupit gjykues me 1 (një) gjyqtar, pasi çështja gjykohet me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, konkretisht: znj. Elvana Çiçolli.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2, gjyqtari Bezart Kaçkini.

Pas shortit të hedhur për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor